



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 409/01 Prot.

Datë 27.3.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë

Drejtuar: Z. Jorgo GORO
Kryetar
Bashkia Himarë

I nderuar Z. Goro,

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 720 Prot., datë 15.03.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 409 Prot., datë 17.03.2017 me lëndë “*Kërkesë për lëshimin Aktit të Përputhshmërisë, për draftin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë*”, Ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas verifikimit të Regjistrit të Integruar të Territorit konstatoi se, Bashkia Himarë ka botuar vetëm dokumentet e fazës së tretë të PPV (Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren), dhe nuk ka bashkëlidhur dokumentet e fazës së parë dhe të dytë (Analizën e Thelluar të Territorit dhe Strategjinë Territoriale). Gjithashtu, mungon edhe materiali në format GIS, për të gjitha fazat.

Për sa më lart, referuar nenit 57 “*Miratimi i PPV-së*”, pika 8, gërma a) të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*”, ju bëjmë me dije se nevojitet botimi i plotë i dokumentacionit të PPV Bashkia Himarë, në Regjistrin e Integruar të Territorit, në mënyrë që AKPT të nisë shqyrtimin e dokumenteve të saj dhe në bazë të vlerësimit të lëshojë Aktin e Përputhshmërisë.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptori, punoi:
B.Laci, E.Pashollari
Datë: 27.03.2017
Nr. Kopje:2